

### INFORMACION MBI NDIHMËN JURIDIKE NË SHQIPËRI

Programet e ndihmës juridike falas nuk zotërojnë dhe as nuk kanë të njëjtin profil publik, sic janë programet e Ndihmës për ekonomike dhe shërbimet shoqërore, ato të shërbimeve shëndetsore publike apo programet në fushën e arsimit publik. Për pasojë, tkurrja e mbështetjes shtetërore dhe fokusi i cunguar i vëmendjes së publikut për ndihmën juridike ka qënë dhe mbetet në masë të madhe si një “krizë e heshtur”.

Shumica e njerëzve me të ardhura të pakta përjetojnë një apo më shumë probleme serioze ligjore, që e bëjnë jetën e tyre të përditshme akoma edhe më të vështirë. Këto probleme juridike zakonisht ekzistojnë në një kontekst me probleme të tjera sociale të lidhura si, vunerabiliteti ekonomik, shëndeti mendor, shëndeti fizik, siguria e jetës, diskriminimi dhe barrierat

e integritit etj. Nga ana tjetër përjetimi i jetës me probleme juridike nga njerëzit me të ardhura të pakta shkakton si rrjedhojë të drejtpërdrejtë “përrjashtimin social” të tyre. Ndaj edhe sot përqasja ndaj fenomenit të përrjashtimit social duhet të shihet nga të gjithë strukturat dhe aktorët si një “proces dinamik i ashpërsuar nga mungesa e aksesit për të plotësuar dhe zgjidhur nevojat juridike, që në fakt përfaqësojnë edhe të drejtat bazë të individit”.



Sot literatura dhe praktika jetësore konkludon se baza e rezultateve të zbatimit të një ligji janë elementë të vështirë dhe hapësira sfiduese për t'u matur. Për pasojë, ndërsa qëllimi kryesor i këtij raporti përvec se të analizojë, të masë dhe të forcojë cilësinë e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, ka edhe një rëndësi më të madhe dhe implikacione më të gjera për të zgjuar vëmëndjen dhe shkundur pluhurin e gjithë agjencive të tjera që duhet të japin ndihmesën në partneritet dhe jo vetëm. Shpresohet që ky raport të ndihmojë në zbatimin e plotë të ligjit nr. 10 039, datë



22.12.2008 "Për Ndhimën Juridike" ( Ligji) , të informojë publikun dhe të inkurajojë debatin publik, duke u përpjekur që të japë formë për përgjegjshmëri realiste, zhvillime politikash dhe mbi të gjitha ofrim të një shërbimi të mire dhe efektiv të komunitetit që duhet të përfitojë atë dhe aktorëve që e ofrojnë ndihmën juridike falas.

Çdo përpjekje për të matur impaktin, rezultatet, anët negative dhe pozitive të shërbimit të ndihmës ligjore falas duhet të analizohet, mbështetet në nevojat ligjore dhe sfidat e punës me shtresat më të disavantazuara të popullsisë dhe klientëve më vulnerabël. Shërbimet humane sikundër janë ato të shërbimeve të ndihmës juridike falas përfshijnë individë, grupe, segmente vulnerabël që kanë dhe përktëhen në impakte në jetët individuale, familjare e më tej. Më tepër sesa prezumimi që impakti i shërbimeve të ndihmës juridike falas është i thjeshtë, i lehtë për t'u matur dhe i parashikueshëm, përjasja që i bëhet në

këtë raport analizës së ligjit njeh ende ndeshjen me vështirësinë dhe paparashikueshmërinë e natyrës së ofrimit të shërbimit ligjor falas që realizohet për shtesat më në nevojë<sup>1</sup>.

Skemat më të mira të ndihmës juridike sot në botë janë bazuar pikërisht në nivelet më të përparuara të kërkimeve për nevojat ligjore të segmenteve vulnerabël, për përparësitë e llojit të cështjeve në grupe të tilla dhe rezultatet e tyre përdoren nga strukturat ekzekutive në planizim, zhvillim dhe menaxhim të këtyre skemave e programeve. Përvoja në botë dhe në vendet europiane me demokraci të përparuar, qartazi thekson se programet e ndihmës juridike duhet detyrimisht të jenë “të orientuara drejt nevojave ligjore dhe socia-

1 Kërkojmë ndjesë dhe sqarojmë se operatorët jo qeveritarë por edhe avokatët privatë që ofrojnë ndihmë juridike falas për individë dhe grupe në nevojë janë më të shumtë se sa ata që janë përmendur ose kanë qënë objekt i këtij studimi, të dhënat e demonstruara në këtë raport nuk përfshijnë të dhënat e tyre, që sigurisht do të plotësonin më mirë realitetin. Shpresojmë se rekomandimet dhe konkluzionet të vlejné për të gjithë ofruesit e këtij shërbimi.



le të shtresave të varfëra të popullsisë”.

Në kushtet që politikat moderne të ndihmës juridike janë bërë përherë e më tepër me natyrë kërkimore si rrjedhim edhe klasa politike do të orientohet dhe bazohet në këto probleme juridike të shtresave më të varfëra të shoqërisë. Shërbimet profesionale të ndihmës juridike udhëheqin sot formimin dhe zhvillimin e politikave dhe programeve sociale në të gjitha vendet. Në këto juridiksione theksimi i qëllimeve për kohezion social dhe rritjen e baraz-

isë sociale, është një rigjenerim modern edhe i politikave të ndihmës juridike falas.

Mendojmë se konkluzionet e gjithëpranuara të ofrimit të ndihmës juridike në rang ndërkom-bëtar duhet të zbatohen edhe në realitetin shqiptar, sepse edhe në këtë vend problemet juridike të njerëzve në nevojë janë të shumta dhe njerëzit nuk mund të përshtaten me to pa ndihmën juridike të ofruar, të financuar nga shteti dhe nga burime të tjera jo qeveritare. Ndihma juridike në Shqipëri, në stadin e zhvillimit që ka, duhet të përfitojë maksimalisht nga eksperiencia e OJF-ve që kanë patur dhe kanë ofruar atë me sukses në vitet e tranzicionit në Shqipëri. Është me rëndësi të theksohet se shtetet me mundësi të kufizuara financiare mund të përfitojnë nga kapacitete të konsoliduara tashmë me experi-encë, përkushtim dhe kualifikim-in e duhur. Le të shërbejë ky ra-port edhe si shtysë për studime të tjera të mirëfillta, për analizën e zbatimit të kornizës legjislative

të ndihmës juridike me pritsh-mëri dhe besim se do të ketë impakt pozitiv në gjithë sistemin e ndihmës juridike në Shqipëri.

### **Aktorët institucionalë për skemën e ndihmës juridike**

Me miratimin e Ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 "Për Ndihmën Juridike" ndihma juridike pritej të ndryshonte në mënyrë rrën-jësore pasi ky, parashikonte përgjegjësi konkrete të agen-cive shtetërore dhe atyre pub-like në implementimin e stand-arteve të avancuara të ndihmës juridike.

Ligji parashikon ngritjen e një organi shtetëror të posaçëm i cili ngarkohet me përgjegjësi të rëndësishme në skemën e funksionimit të ndihmës juridike. Ky organ, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ( KSHNJ), është ngritur si organ kolegjal me përfaqësi nga subjekte të cilat luajnë rol të rëndësishëm në funksionimin e ndihmës ju-ridike, përkatësisht Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Dhoma Kombëtare e Avokatisë,

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe një përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e ndihmës juridike.

Ndonëse fillimi i funksioneve të këtij organi shtetëror u vonua, Viti 2012 e gjeti këtë organ në mundësi të plotë për të përm-bushur detyrat e tij të parashi-kuara nga Ligji.

Në qershor të vitit 2011, KSHNJ miratoi aktet nënligjore të do-mosdoshme për të bërë të mundur zbatimin e Ligjit, pra për të ndjerë konkretisht efektet e zbatimit të tij në ndihmë të per-sonave të cilët Ligji i parashikon si target- grup përfitues. Me mi-ratimin e buxhetit në dispozicion të KSHNJ, fillimi i vitit 2012 kon-siderohej si një vit në të cilin do të fillonte të ndjehej normalisht efekti i zbatimit të Ligjit në prak-tikë për ndihmën juridike.

Vonesa për miratimin e akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit Për Ndihmën Juridike u pasua dhe me vonesën e boti-mit të tyre në Fletoren Zyrtare që

u bë në dhjetor 2011. Vendimi i KSHNJ për caktimin e avoka-tëve që do të ofrojnë ndihmë ju-ridike, është aplikuar/zbatuar në Maj 2012 me shpalljen e njoftimit nga KSHNJ për procedurën e konkurrit. Sigurisht që vonesat në miratimin, hyrjen në fuqi dhe në dhe zbatimin e këtyre ak-teve nënligjore kanë ndikuar në mungesën e ofrimit të ndihmës ligjore falas për çështjet civile të mbështetura nga shteti.

Me gjithë përmirësimet në plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e sistemit të ndihmës juri-dike, shqetësime për përputhsh-mërinë e ofrimit të këtij sistemi në raport me standardet e Këshillit të Europës janë evidentuar së fundmi në letrën e Komisionerit të të Drejtave të Njeriut të Këshil-lit të Europës, Nils Muiznieks, dër-guar ministrit të Drejtësisë, Halimi<sup>2</sup>. Komisioneri i të Drejtave të Njeriut rendit në mënyrë të de-tajuar dhe shqetësuese një sërë

<sup>2</sup> Letër e Komisionerit të të Drejtave të Njeriut, Nils Muiznieks, të Këshillit të Europës, drejtuar minis-trit të Drejtësisë Eduart Halimi, datë 15 tetor 2012, aksesuar në [http://www.coe.int/t/commissioner/News/2012/121106Albania\\_en.asp](http://www.coe.int/t/commissioner/News/2012/121106Albania_en.asp).



problematikash që vihen re në sistemin shqiptar të ofrimit të ndihmës juridike. Rekomandimet synojnë në thelb rishikimin dhe përmirësimin e sistemit kombëtar të ndihmës juridike në përputhje me standardet e Këshillit të Europës për të ndihmuar efektivisht personat që janë në një situatë ekonomike ose sociale të vështirë të gëzojnë të drejtat e tyre.

Ministria e Drejtësisë si institucion përgjegjës duhet të kontrollojë më mirë veprimtarinë e KSHNJ, rolin e saj të veçantë në administrimin e ndihmës juridike, zbatimin nga ky autoritet të dispozitave ligjore dhe nënligjore e cilësinë e ofrimit të kësaj ndihme. Buxheti i parashikuar për ndihmën juridike përfshihet në zërin shpenzime operative, por ai duhet të jetë buxheti vjetor që i vecantë që i akordohet KSHNJ.

Vlerësues të ndryshëm të punës së KSHNJ kanë evidentuar nivelin e ulët të transparencës së veprimtarisë së këtij Komisioni dhe

të informacionit për veprimtarinë e tij. Ky konstatim është evidentuar në mënyrë të veçantë në takimet e organizuara me organizatat jofitimprurëse që operojnë në fushën e ndihmës juridike dhe aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të interesuar për funksionimin e ndihmës juridike në Shqipëri.

Gatë vitit 2011, KSHNJ ka refuzuar 27 kërkesa aplikantësh për ndihmë juridike (14 çështje penale dhe 13 çështje civile) për shkak të mangësive në dokumentacion të tyre.

KSHNJ raporton për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë më 15 shtator 2012, se janë nënshkruar kontrata me shtatë avokatë dhe katër OJF për ofrimin e ndihmës juridike, bazuar në vendimin nr.90, datë 15.6.2012. Po në vitin 2012, KSHNJ ka miratuar dhënien e ndihmës juridike për 8 raste (5 raste penale dhe 3 civile), si dhe ka miratuar kërkesën e TLAS, si OJF, për të ofruar ndihmë juridike specifikisht për komunitetin

Rome, për 17 raste të regjistrimit të lindjeve me procedura administrative ( me ndihmë juridike parësore) dhe 16 rasteve të kujdestarisë ( me ndihmë juridike dytësore) .

Por duhet theksuar se plotësimi i formularit dhe i dokumentacionit përkatës pa asistencë nga qytetarët vulnerabël që kërkojnë ndihmë juridike, rezultoi të jetë i vështirë, për shkak jo vetëm të një numri të madh dokumentesh (7 vërtetime) që duhet të mbledhen dhe të dërgohen pranë KSHNJ, por edhe si e ku të drejtohen apo adresohen. Kjo procedurë rezultoi të jetë e ndërlikuar për shtetasit shumë të varfra të popullsisë dhe me nivel të ulët arsimor, anëtarët e minoriteteve por edhe migrantë të tjerë, të cilët kanë nevojë të asistohen për informim dhe plotësim të dokumentacionit përkatës.

Në skemën e funksionimit të ndihmës juridike ka disa paqartësi. Psh një paqartësi rezultoi edhe në kontraktimin e

çështjeve penale. Sipas Ligjit KSHNJ është përgjegjës për ndihmën juridike si për çështjet penale ashtu edhe për ato civile. Por, për shkak të funksionimit të mëparshëm të ndihmës juridike në fushën penale ende fondet që janë të nevojshme për të mbështetur pagesat e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike në fushën penale i transferohen organeve, të cilat në zbatim të ligjit procedural, caktojnë avokatët që do të ofrojnë këtë ndihmë, pra gjykatave dhe prokurorive. Është detyrim i KSHNJ që të kërkojë rregullimet specifike ligjore dhe organizative që këto fonde të kalojnë në dispozicion të KSHNJ për të përmbushur përgjegjësitë e saj të përcaktuara nga Ligji. Por, në kushtet aktuale nuk është efektive mbivendosja e skemës, pra ofrimi i ndihmës juridike në fushën penale pjesërisht nga avokatët që caktohen dhe paguhen nga organet e prokurorisë dhe gjykatës dhe pjesërisht nga avokatët që kontraktohen nga KSHNJ. Kjo mbivendosje krijon konfuzion në funksionimin e skemës

së ndihmës juridike, ndërkohë që çështjet civile janë pothuaj të pambuluara nga KSHNJ në raport me kërkesat reale.

Konstatohet se mungon informacioni për ekzistencën/vendndodhjen e KSHNJ, për përmbajtjen e ligjit dhe të akteve nenligjore, për kategoritë përfituese të ndihmës juridike, procedurën e aplikimit dhe të plotësimit të dokumentacionit, të cilat vazhdojnë të kufizojnë ndjeshëm aksesin në ndihmën juridike. KSHNJ ende nuk ka

hapur një faqe të vecantë në internet ku të publikojë informacione të domosdoshme për të interesuarit e shumtë si dhe për vet ofruesit e ndihmës juridike. Një tjetër pengesë përbën praktika aktuale e mos funksionimit të sitemit të ndihmës juridike veçanërisht për qytetarët që banojnë jashtë Tiranës. E vetmja mundësi kontaktimi me KSHNJ ka mbetur kontakti i drejtpërdrejtë me stafin e KSHNJ brenda mjediseve të Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e pritjes së popullit, gjë që mund të bëhet rrallë dhe vetëm nga një kategori e vogël personash nevojtarë për ndihmë juridike. Një zgjidhje efektive do të ishte kontraktimi i një avokati në çdo qark me qëllim ofrimin e ndihmës parësore dhe përgatitjen e kërkesave për ndihmë juridike dhe dërgimin/komunikimin elektronik në KSHNJ, sic u theksua në konkluzionet e tryezës së rumbullakët “Për perspektivën e ndihmës ligjore në Shqipëri”, datë 23 maj 2012, organizuar nga CRD, EURALIUS, AP, DHKA, TLAS dhe Civil Rights Defenders.





### Disa rekomandime:

- Kërkohet një menaxhim dhe përdorim më efikas i buxhetit të alokuar për Komisionin e Ndihmës Juridike. Konkretisht po t'i referohemi ligjit Për Ndihmën Juridike del se kostot e çështjeve ligjore që trajtohen me ndihmë juridike parësore janë shumë më të ulta se të çështjeve që ndiqen me ndihmë juridike dytësore.

- KSHNJ duhet të jetë më operativ dhe më transparent në publikim të informacioneve dhe në marrjen e vendimeve në mënyrë që edhe kur fondi i akorduar është më i vogël se sa nevojat ekzistuese, ai të shrytëzohet në përputhje me kërkesat e aplikantëve dhe ofruesve të ndihmës juridike. Po kështu me operativitet të veprohet edhe për ndërmarrjen e vendimeve të tjera të diktuar nga testimi i ligjit në praktikë, pengesat që hasen për funksionimin e sistemit të ndihmës juridike apo nga propozimet të tjera drejtuar KSHNJ. Psh propozimi për amendimin e

ligjit për shmagjen nga taksat gjyqësore të aplikantëve me të ardhura të pakta financiare, etj.

- Nënshkrimi i Marrëveshjeve të bashkepunimit midis KSHNJ dhe organizatave apo institucioneve të jetë më konkret dhe më funksional në këndvështrimin e realizimit me efikasitet të ndihmës juridike. Psh. nënshkrimi i marrëveshjes me Avokatin e Popullit, ku drejtohen një numër shumë i madh ankesash apo kërkesash nga populli dhe që një pjesë e tyre duhet të shërbejnë e rekomandohen për ndihmë juridike, presupozon që këto raste të mbështeten financiarisht nga KSHNJ.

- Duhet të ketë organizim qoftë edhe ad hoc nga KSHNJ, për pritjen e aplikimeve të njerëzve në nevojë për ndihmë juridike të paktën në rang qarku apo dhomash avokatie. Nuk është vështirë të nënshkruhen akt marrëveshje me avokatë në këto qarqe të cilët në një orar të caktuar presin aplikimet, drejtojnë kërkesat, etj, në mënyrë që të

ndihet zbatimi i ligjit edhe pse në kushte të limituara fondesh. Nga eksperiencia në rajon dhe me fqinjët shohim se edhe pse shuma e vene ne dispozicion të ndihmës juridike është e kufizuar në raport me nevojat e popullsisë, organizimi i sistemit ka frymëmarrje dhe njihet nga popullata.

### Ofruesit e ndihmës juridike

Me vendimin nr. 2 datë 25.6.2011, "Për rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të

avokatisë dhe OJF-të që do të ofrojnë ndihmën juridike" të KSHNJ janë përcaktuar rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të avokatisë apo OJF-ve që do të ofrojnë ndihmën juridike.


Neni 11 i Ligjit përcakton se ndihmë juridike mund të ofrojnë vetëm avokatët e licencuar si të tillë, pavarësisht nëse ushtrojnë aktivitetin e tyre si individë, të organizuar në zyra avokatie apo si përfaqësues të OJF-ve që ofrojnë shërbime juridike falas.

**Per të patur një pasqyrë të të dhënave nga OJFtë që ofrojnë shërbime juridike për periudhën 2011-2012, përmes pyetësorëve të shpërndarë doli se:**


| Ofrues il ndihmës juridike                            | Republika |      | ADRIF |      | KSHH |      | QSHPLI |      | TLAS |      | Mbeshtetur |
|-------------------------------------------------------|-----------|------|-------|------|------|------|--------|------|------|------|------------|
| Periudha                                              | 2011      | 2012 | 2011  | 2012 | 2011 | 2012 | 2011   | 2012 | 2011 | 2012 | Donatore   |
| Keshillim                                             | 340       | 370  | 630   | 198  | 800  | 533  | 210    | 110  | 237  | 243  | Donatore   |
| Pergatitje dokumentash                                | 340       | 370  | 281   | 107  | 6    | 6    | 108    | 100  | 510  | 459  | Donatore   |
| Ndihme juridike gjate procesit gjyqesor pa perfaqesim | 340       | 370  | 2     | 3    | 1    | 1    | 108    | 110  | 457  | 389  | Donatore   |
| Perfaqesime ne gjykate                                | 30        |      | 19    | 11   | 10   | 10   | 21     | 25   | 312  | 280  | Donatore   |
| Total                                                 | 1050      | 1020 | 932   | 319  | 817  | 550  | 447    | 355  | 1516 | 1371 | Donatore   |

*Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve, në tabelën e mësipërme, janë paraqitur dhe në grafikët e mëposhtëm:*

**Grafiku nr.1**



**Grafiku nr.2**



### Rekomandime të tjera:

- Nevojat e qytetarëve duhet të analizohen dhe të studiohen. Këto analiza do të jepnin pasqyrën reale dhe më të thellë të problemeve ligjore që janë përparësi për qytetarët, do të përcaktonin shkallën e rëndësisë së tyre, arsyet dhe pengesat e hasura në procesin e zgjidhjes dhe kush mund të jenë rrugët e zgjidhjes. Analiza do të orientonte drejt propozimeve të mbështetura për amendime ligjore në funksion të rritjes së aksesit në drejtësi, amendime për përmirësimin e politikave dhe programeve sociale, etj.

- Shtrirja dhe llojshmëria e prioriteve të çështjeve ligjore individuale të ligjshme për përfitimin e ndihmes juridike duhet të rishikohet periodikisht, në mënyrë që të shmangen paqartësitë apo arbitraritetet e mundshme dhe mangësitë që në aplikim. Ndihma juridike duhet të jetë një instrument që garanton akses të barabartë në drejtësi në vendin tonë për të gjithë.

- Njohja e dallimit mes ndihmës juridike parësore dhe asaj dytësore është me rëndësi të vecantë për aplikantët, ajo nuk ndryshon vetëm në formën dhe përmbajtjen e llojit të shërbimit por ajo është e lidhur ngushtë dhe me dy faktorë përcaktues për përfitimin e saj: nivelin arsimor dhe atë të shkallës së varfërisë së aplikantit. Nisur nga mundësitë e kufizuara të buxhetit për ndihmë juridike, dallime të tilla bëhen përcaktuese si në vendimin e KSHNJ ashtu edhe në vendimin e ofruesve të ndihmës juridike. Fakori arsimor është i lidhur ngushtë me paaftësinë për përgatitjen e dokumentave



qoftë për procedurat administrative qoftë për t'u orientuar në vorbullën e llojit të të drejtave që i janë mohuar dhe që i takojnë për ushtrimin e të drejtave të tyre kushtetuese dhe ato të përcaktuara me ligj. Këto përfshijnë plotësimin e aplikimeve që nga dokumentet identifikuese, ankimime për mohimin e ndihmës ekonomike apo sociale, respektimin dhe mos humbjen e afateve të parashikuara, etj.

- Praktika e deritanishme e zbatimit të ligjit por edhe e ofruesve me eksperiencë në këtë fushë dikton që ndihma juridike parësore nuk mund t'i nënshtrohet të njëjtës procedurë aplikimi me atë dytësore, gjë që është theksuar edhe nga programi EURALIUS, ajo duhet të jetë më e thjeshtuar dhe më e përshtatshme. KSHNJ duhet të veprojë më me shpejtësi për marrjen e vendimeve të tilla që thjeshtojnë procedurat dhe ndihmojnë shmangjen e pengesave të hasura në praktikë. Masat e përmendura më sipër do të rishtojnë besimin dhe shmangin



skeptizimin të aplikantët por edhe të ofruesit e autorizuar për shërbimin e Ndhmës Juridike. **Procedura për dhënien e ndihmës juridike parësore është e thjeshtuar dhe e shpejtë por duhet të shoqërohet me krijimin e kushteve konkrete për të qenë efektive duke kontraktuar operatorët që do t'a ofrojnë atë.**

- Përsa i përket ofrimit të ndihmës juridike parësore, është i nevojshëm një koordinim i zgjeruar midis OJFve të autorizuar për të siguruar ndihme juridike parësore, nga njëra anë, dhe





KSHNJ në anën tjetër, në mënyrë që të arrihen Marrëveshje Bashkëpunimi mbi bazën e praktikave efektive, ku shërbehen një numër i madh klientësh dhe me kosto të ulët. OJF -të dhe dhomat e avokatisë në shkallë qarku kanë kapacitete organizative të përshtashme për shërbim juridik parësor, të stacionuara në mënyrë fikse, të aksesueshme dhe të shpejtë, të cilat mund të shfrytëzohen mjaft mirë nga KSHNJ si për kostot e pranueshme edhe për cilësinë e shërbimeve. Gjithashtu ofruesit e autorizuar nga KSHNJ për ndihmë juridike

parësore bëhen në të njëjtën kohë “filtrues” të specializuar në përzgjedhjen e rasteve që kërkojnë ndihmën juridike falas.

- Të dhënat e deritanishme nga KSHNJ flasin për mungesë transparence të publikimit të numrit të aplikantëve, të llojit të çështjeve të paraqitura, të shqyrtimit dhe vendimit të pranimi apo refuzimit. Funkcionimi i skemës së ndihmës juridike kërkon që autoriteti kompetent të respektojë afatet sipas ligjit, të përcaktojë një metodologji të qartë për qasje sa më të lehtë të qytetarëve, shqyrtimin e aplikimeve, vendim marrjen dhe mënjanimin e vonesave të panevojshme. Nga studimi del se edhe vetë vendimet e miratuara nga KSHNJ, psh Vendimi 3, lidhur me afatet e kërkesës, ankesës dhe shqyrtimit, nuk repektohet nga ky autoritet.

**Bazuar në pyetsorët e shpërndarë në OJF që ofrojnë shërbime juridike del se grupet e synuara kanë qënë fëmijët**

vulnerabël, fëmijët e shfrytëzuar, të abuzuar, të trafikuar, gratë vulnerabël, gratë e dhunuara, të trafikuar, personat me aftësi të kufizuara, të burgosurit, të paraburgosurit, viktimat e tjera të dhunës apo trafikimit, pensionistët, të moshuar të vetmuar, minoritetet kryesisht ata Romë dhe Egjiptianët, antarë të LGBT, të tjerë pjestarë të familjeve eks-tremisht të varfra, etj.

**Llojet e çështjeve ligjore civile për të cilat është ofruar ndihma juridike falas parësore apo dytësore nga OJF te kanë të bëjnë me:** të drejtat në fushën sociale, shëndetësore, të drejtën e pensionit, invaliditetit, të drejtat në fushën e marrëdhënieve të punës, mbrojtja e të miturve, mbrojtja e viktimave të dhunës në familje, mbrojtja e viktimave të veprave penale; mbrojtja e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, çështjet e strehimit, çështjet e statusit (heqja e zotesisë për të vepruar të personit, caktimi i kujdestarit), marrëdhëniet familjare, regjistrimet civile, të shkeljes së të dre-



jtave dhe lirive të njeriut dhe raste të diskriminimit, etj.


Për të patur një pasqyrë më të detajuar për përfituesit / klientë për rastet e trajtuara nga OJF të me ndihmë juridike parësore dhe dytësore, gjatë periudhës 2011-2012, të përmënduara në tabelat dhe diagramat e mëposhtme, bazuar dhe në të dhënat e data bazës së ofruesve të ndihmës juridike po japim disa paraqitje grafike të përfituesve/klientëve sipas vëndbanimit, gjinisë, moshës, gjëndjes civile, përkatësisë etnike, burimit të të ardhurave, kushteve të banimit, sipas madhësisë familjare, numrit të të rriturve, numrit të fëmijëve dhe sipas frekuencës së aplikimeve për ndihmë juridike.

Me këto paraqitje grafike shpresojmë të ndihmojmë për të parë më qartë profilin social të përfituesve dhe për të arritur në konkluzione rreth kategorive dhe individëve që janë më së shumti të interesuar të aplikojnë për ndihmë juridike<sup>3</sup>.




<sup>3</sup> Theksojmë se janë studjuar të gjithë klientët që janë paraqitur në grafikun nr. 1 dhe nr. 2


Përfitues/Klientë sipas gjinisë  
2011 dhe 2012




Përfitues/klientë sipas vëndbanimit  
2011 dhe 2012




**Përfitues/Klientë sipas gjendjes civile  
2011 dhe 2012**




**Përfitues/Klientë sipas përkatësisë etnike  
2011 dhe 2012**



## Përfitues/Klientët sipas burimit të të ardhurave 2011 dhe 2012




## Përfitues/Klientë sipas kushteve të banimit 2011 dhe 2012







### Familje që kanë përfituar ndihmë juridike sipas madhësisë 2011 dhe 2012




### Familje që kanë përfituar sipas numrit të të rriturve 2011 dhe 2012



Familje që kanë përfituar sipas numrit të fëmijëve  
2011 dhe 2012



Ecuria e aplikimeve të përfituesve sipas muajve  
2011 dhe 2012



## 6. DISA KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike të bashkëpunojë më gjërë me organet bashkëpërgjegjëse për ndihmën juridike, Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

- Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë të konsultojë masat e nevojshme ligjore dhe organizative për të ushtruar përgjegjësitë e saj në ndihmën ligjore në procesin penal.

- Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike të ndërtojë politika efikase për të njohur personat e interesuar për përfitimin e ndihmës juridike me procedurat dhe mundësitë e përfitimit të saj. Për të rritur efikasitetin e këtyre aktiviteteve, përveç përdorimit të mjeteve të informimit masiv, përfshirë por pa u kufizuar, publikimin e një faqeje zyrtare

elektronike, të rrisë bashkëpunimin me ofruesit e ndihmës juridike, veçanërisht OJF-të që ofrojnë ndihmë juridike, që të ndërgjegjësojnë grupet e interesuara nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese të tipit "street law", broshura informuese etj.

- Të zgjerojë numrin e avokatëve, zyrave të avokatisë, OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike të kontraktuar si dhe të zgjerojë hapësirat gjeografike të të kontraktuarve për ofrimin e ndihmës juridike.

- Të aplikojë ndihmën ligjore parësore, duke shfrytëzuar dhe jo vetëm, OJF-të që ofrojnë ndihmë juridike.

- Të nxisë kontraktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë apo OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike për të aplikuar forma të ndihmës juridike të pjesshme, si "ndihmë juridike në formën "clinic", "këshillime ligjore me mjetet e komunikimit në distancë" me qëllim që të rritë numrin e përfituesve të ndihmës juridike me

burime financiare të kufizuara.

- Në kushtet aktuale të ndihmës juridike në procesin penal qw financohet nga organet e prokurorisë dhe gjykatat, duhet të sigurohet një bashkëpunim më konstruktiv me DHKA për të ndërhyrë në parashikimin e rregullave që sigurojnë mundësinë e të pandehurve të zgjedhin avokatin si dhe të monitorohet cilësia e mbrojtjes së avokatëve të caktuar nga organet e prokurorisë dhe gjykatat.
- Të kujdeset për zgjerimin e ndihmës juridike në procesin penal në fazën e ekzekutimit të vendimeve duke siguruar minimalisht ndihmë juridike parësore.
- Të promovojë fillimin e procedurave të ndryshimit të ligjit për përjashtimin e përfituesve nga pagimi i taksës (tarifës) gjyqësore.
- Të bashkëpunojë me Ministrin e Drejtësisë për të lehtësuar përfituesit e ndihmës juridike nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore.

**RELACIONI I PËRGATITUR NGA  
TLAS PËR PROJEKTLIGJIN  
“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.10  
039, DATË 22.12.2008  
“PËR NDIHMËN JURIDIKE””**

Miratimi në vitin 2008 i ligjit “Për ndihmën juridike” përbën një hap me rëndësi në legjislacionin shqiptar, dhe shënoi, ndonëse me vonesë, zbatim të detyrimit kushtetues të shtetit për shtresat më në nevojë, por njëkohësisht edhe plotësim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Europian. Sfidë më e vështirë pas miratimit dhe publikimit të tij mbetet zbatimi i saktë dhe i plotë i këtij ligji në praktikë. Pikërisht për të përmirësuar zbatimin e tij në praktikë dhe njëkohësisht për të ngritur në një dimension të ri detyrimin shtetëror dhe zbatimin e tij sa më plotë dhe efektiv, është menduar amendimi i tij në një pikë të vecantë që ka të bëjë me shumën në të holla që duhet të parapaguhet në momentin e ngritjes së padisë si dhe më pas të përballimit të shpenzimeve të tjera

gjyqësore, nga personat që përfitojnë ndihmën juridike.

Projektligji që paraqitet për shqyrtim dhe miratim ka si synim që të përjashtojë këtë kategori që përfiton ndihmën juridike nga taksa mbi aktet- sipas terminologjisë që përdor Kodi i Procedurës Civile - dhe tarifat për shërbimet e administratës gjyqësore - sipas terminologjisë që përdor ligji "Për taksat kombëtare".

Është e domosdoshme që të miratohet ky amendament si pjesë e detyrimit ligjor që kanë autoritetet shtetërore në ofrimin e ndihmës juridike. Në situatën aktuale është qartazi e pazgjedhur çështja se kush paguan detyrimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore për kategorinë e përfituesve të ndihmës juridike. Shteti merr përsipër financimin e mbrojtjes dhe përfaqësimit e interesave të tyre në gjykimet civile dhe administrative sepse ka detyrimin e përkrahjes për këtë shtresë, pikërisht përshkak të mungesës së mjeteve finan-



ciare të saj. Për pasojë është gjithashtu e domosdoshme edhe përjashtimi i kësaj shtrese dmth përfituesit e ndihmës juridike në raste e ngritjes së padive- nga taksat apo tarifat e ngritjes së padive civile dhe administrative në gjykatë dhe nga shpenzimet e tjera gjyqësore pikërisht për këtë shkak. Qartazi pagimi i tyre nga ana e përfituesit të ndihmës juridike është i pamundur për shkak të gjendjes së tyre ekonomike sociale, dhe për pasojë kjo gjë përbën për ta masë diskriminues në çështjen e aksesit në gjykatë.

Në këtë mënyrë mbështetja që ofron shteti është reale dhe

aspak iluzive, por njëkohësisht është edhe efektive. Modeli sipas të cilit është hartuar ky projektligj është ai i nenit 14 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" që përcakton se: "4. Kërkuesi shkarkohet nga taksat e gjykatës. Me daljen e urdhrit të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Në rast të kundërt, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit."



Pra, përjashtimi është bërë në ligjin e vecantë që ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe normon fushën e marrëdhënieve shoqërore të fushës. Po ashtu ky ligj është zbatim i drejtpërdrejtë i përcaktimit që bën neni 102 i Kodit të Procedurës Civile që përcakton se: "Shpenzimet gjyqësore përbëhen nga taksat mbi aktet, shpenzimet për aktet që kryhen, si dhe nga shpenzimet e tjera të nevojshme të gjykimit. Për ngritjen e padisë paguhet taksa mbi aktet në rastet dhe në masën e caktuar sipas ligjit."

Ndërkohë neni 105/b i Kodit të Procedurës Civile vijon me përcatimin se: "Personat që, sipas dispozitave për taksën mbi aktet, përjashtohen nga pagimi i taksës, përjashtohen edhe nga pagimi i shpenzimeve të tjera gjyqësore. Në këto raste, shpenzimet përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit"

Me miratimin e këtij projektligji, do të bëhët i mundur një mbrojtje me efektive e interesave dhe të drejtave në gjykatë që kanë shtetasit që përfitojnë ndihmën juridike. Projektligji do të



bëjë të mundur gjithashtu përmirësimin e aksesit në gjykatë të këtyre shtresave për çështje të interesave të tyre të ligjshme. Kjo përbën njëkohësisht edhe një detyrim kushtetues dhe është zbatim i drejtpërdrejtë në të drejtën e brendshme i nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Projektligji ka efekte financiare të cilat janë paraqitur më poshtë. Efekte financiare të këtij projektligji janë llogaritur dhe janë mbështetur në shumën që buxheti i shtetit i alokon ndihmës juridike për vitin 2012.

### Shtese

Në këto rregullime normative bie në sy mungesa e përjashtimit nga pagimi i tarifës gjyqësore i personave që janë përfitues të Ligjit "Për Ndihmën Juridike". Për rrjedhojë, një person i cili, për shkak të pamundësisë financiare është përfitues i ndihmës juridike dhe, për këtë arsye përfiton të drejtën të përfaqësohet në gjykim me avokat të paguar nga shteti, mund të vihet në pamundësi të realizojë gjyqësisht të drejtat e tij ligjore të mohuara për shkak se paraqitja prej tij e çështjes në gjykatë kushtëzohet me pagimin e detyrueshëm të tarifës gjyqësore e cila mund të jetë e papërballueshme për të.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ  
Nr. 143 , Datë 02.05.2013**

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.10 039, DATË 22.12.2008  
“PËR NDIHMËN JURIDIKE”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, bëhen shtesat si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 11, pas paragrafit të 2, shtohet paragrafi 3, me këtë përmbytje:

“3. Ndihma juridike përfshinë edhe përjashtimin në proceset gjyqësore civile dhe administrative të individit nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe i shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.”.

**Neni 2**

Në nenin 12, pas shkronjës “dh”, shtohet shkronja “e” me këtë përmbytje:

“e) përjashtimin në proceset gjyqësore civile dhe administrative nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe i shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.”

## 2 Neni 3

Pas nenit 12, shtohet neni 12/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

### “Neni 12/1

Klinikat Ligjore Vendore

1. Dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, për aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera këshillimi të grupeve në nevojë, bëhet nëpërmjet Klinikave Ligjore Vendore. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore, nuk i nënshtrohet asnjë forme. Ajo mund të paraqitet edhe gojarisht pranë Klinikave Ligjore Vendore.
2. Klinikat Ligjore Vendore japin asistencë edhe për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, si dhe dokumenteve që duhet t'i bashkëngjiten formularit tip të kërkesës.
3. Klinikat Ligjore Vendore organizohen të paktën në të njëjtin numër me atë të Gjykatave të Apelit. Struktura dhe organika e Klinikave Ligjore Vendore është pjesë e strukturës dhe organikës së Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike dhe sekretariatit të tij.
4. Rregullat e hollësishme për funksionimin e Klinikave Ligjore Vendore, si dhe për ofrimin prej tyre të ndihmës juridike parësore, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.”.

#### Neni 4

Në nenin 13, bëhen këto shtesa:

a) Pas shkronjës “b”, të paragrafit 1, shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) kanë nevojë të mbrojnë të drejtat e tyre, nëpërmjet paraqitjes së kërkesë-padisë, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar taksën mbi aktet, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se:

i. përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t’u përfshirë në to; ose

ii. është viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to.

b) Në paragrafin 4, pas togfjalëshit “ka detyrimin të bashkëpunojë”, shtohet togfjalëshi “ me Komisionin Shtetëror të Ndihmës Juridike,”.

#### Neni 5

Në nenin 15, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) gjendjen ekonomike të kërkuarit.”.

#### Neni 6

Në nenin 16, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike, në formën e përjashtimit nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, duhet të paraqitet personalisht nga kërkuari apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Formulari i kërkesës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.”.

### **Neni 7**

Pas nenit 21, shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

#### **“Neni 21/1**

#### **Përrjashtimi nga pagimi i taksës mbi aktet**

1. Kërkesa për përrjashtimin nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, shqyrtohet nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës. Rregullat dhe kriteret e hollësishme për shqyrtimin dhe pranimin e kërkesës, përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

2. Nëse Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike nuk shprehet brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, ose vendos refuzimin e kërkesës për 4 përrjashtimin nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, gjykata nëse vlerëson se përmbushen kushtet për të përfituar ndihmën juridike, sipas shkronjës “c”, të paragrafit 1, të nenit 13, gjatë veprimeve përrgatitore, vendos përrjashtimin e paditësit nga pagimi i taksës mbi aktet.

3. Nëse Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike konstaton se gjendja ekonomike e personit është e tillë që pamundëson pagimin e taksës mbi aktet, pavarësisht se nuk plotëson kushtet për të përfituar ndihmën juridike, sipas shkronjës “c”, të paragrafit 1, të nenit 13, mund të vendos që pagimi i taksës mbi aktet të bëhet sipas rregullave të parashikuara me vendim të Komisionit, në një kohë të mëvonshme, ose me këtë. Rregullat dhe kriteret për shtyrjen e periudhës së pagimit të taksës mbi aktet, përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, pas të këtë marrë mendimin e Ministrisë së Financave.”.

**Neni 8**

Pas nenit 22, shtohet neni 22/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

**“Neni 22/1**

**Dispozitë kalimtare**

**1.** Ngarkohet Këshilli i Ministrave të marrë masat e nevojshme për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin normal të veprimtarisë së Klinikave Ligjore Vendore, si dhe planifikimin e fondeve të nevojshme buxhetore në Buxhetin e Shtetit të vitit 2014 për funksionimin e tyre.

**2.** Këshilli i Ministrave merr të gjitha masat e nevojshme për hapjen e Klinikave Ligjore Vendore brenda datës 01.01.2014.”.

**Neni 9**

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**JOZEFINA TOPALLI (ÇOBA)**





## Vet Përfaqësimi, metodë efektive për rritjen e aksesit në drejtësi

Shumë qytetarë nuk kanë mundësi financiare për të marrë një avokat, që të këshillohen apo përfaqësohen në Gjykatë. Ata i klasifikojmë në dy kategori.

Kategoria e parë përfshin qytetarët e varfër por të arsimuar, dhe me aftësi për të kuptuar e zbatuar këshillat ligjore të dhëna nga avokati, dhe si rrjedhim të aftë për të ndjekur çështjen në gjykatë apo administratë duke u vetpërfaqësuar.

Kategoria e dytë përfshin qytetarët e varfër që nuk e kanë arsimin e duhur për t'u vetpërfaqësuar si në Gjykatë edhe në strukturat përkatëse të Administratës.

Ky shkrim i drejtohet kategorisë së parë që u përmend më sipër dhe që kanë në duart e tyre një numër të madh letrash e dokumentash,



të cila duhen interpretuar, argumentuar dhe bazuar në legjislacionin përkatës.

Dihet që të ardhurat ekonomike janë një kriter i rëndësishëm, jo të gjithë qytetarët kualifikohen për të përfituar Shërbim Ligjor Falas, prandaj numri i atyre që janë të interesuar të përfaqësojnë vetveten, apo të shërbejnë me Clinics, duke u aftësuar për ta bërë një gjë të tillë, ka ardhur duke u rritur.

Detyra e avokatit që ofron shërbimin clinics shkon përtej përgatitjes së kërkesë padisë, apo kërkesës drejtuar strukturave administra-

tive, kjo për arsyen e thjeshtë se klientit që do të vetpërfaqësohet në instancën përkatëse, i lindin pengesa dhe pyetje të tjera të paqarta gjatë procesit ose do t'i duhet të përpiqet të gjej apo të sigurojë një dokument që lidhet me rastin, kështu që ai ka privilegjin të rikthehet hap pas hapi te avokati për tu këshilluar në të gjithë procedurën e kërkuar.

Në të njëjtën kohë avokatët përdorin edhe teknologjinë e komunikimit për shkëmbimin e informacionit por më tepër se bisedave përmes telefonit ata i japin rëndësi përgjigjeve me shkrim përmes

emailit, në mënyrë që qytetarët të mos konfuzohen në rast se nuk e mbajnë saktësisht mend keshillën që u jepet me gojë.

Sigurisht marrëdhëniet me gjyqatrin janë një tjetër çështje sepse sjellja e tyre nuk është gjithmonë favorizuese. Ka raste që ata janë cuditërisht shumë të durueshëm me klientin e paraqitur, por ka edhe raste që ata nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur pales që vet përfaqësohet.

E rëndësishme në ofrimin e shërbimit clinics apo të vetpërfaqësimit nga TLAS, është se avokatit i kërkohet të jetë po aq profesional sa edhe me çështjet që ai përfaqëson, duke i trajtuar ato në mënyrë qualitative.

### **I. Pse palët duhet të përfaqësojnë vetveten?**

Shumica e palëve të vetë-përfaqësuar për çështjet civile, të shërbyer nga avokatët e TLAS, kur u pyetën se pse ata nuk kanë takuar një avokat, japin përgjigjet e mëposhtme:



1. "Unë nuk mund të përballoj një avokat"; ose
2. "Rasti im është mjaft i thjeshtë dhe mund ta trajtoj edhe personalisht."

Duke pasur parasysh tarifat e larta të kontraktimit të një avokati, për individët me të ardhura të ulëta kjo është e pamundur. Madje edhe për individët me të ardhura mesatare kostoja e avokatit përfaqëson një barrë të konsiderueshme që mund të kenë ndikime afatgjata mbi stabilitetin financiar të familjes.

Nga ana tjetër programet e Ndihmës Juridike të ofruara nga shteti apo nga OJF, nuk janë në gjendje për të plotësuar nevojën për përfaqësim të njerëzve të varfër.

Madje praktika po tregon se deri me sot ndihma juridike falas për çështje civile u ofrohet vetëm rreth 20 për qind të njerëzve që kanë nevojë për këtë ndihmë.

### **II. Cilat janë pengesa për palët që Vetë-Përfaqësohen në sistemin gjyqësor?**



Pavarësisht përpjekjeve të shumta në përmirësimin e qasjes në gjykata për të vetë-përfaqësuarit, ata ende përballen me pengesa të shumta si:

- Barriera e terminologjisë ligjore-gjuha e specializuar dhe termat ligjorë të përdorur në gjykata, veprojnë si një pengesë. Njerëzit që vetë përfaqësohen shpesh ekanë jashtëzakonisht të vështirë për të kuptuar fjalët e përdorura në sallën e gjyqit, sidomos kur gjyqtari dhe stafi përdorin edhe ni terma latine. Kjo është edhe më e komplikuar për ata që kanë një nivel të ulët kulturor.

- Komplexiteti i Gjykatave, ku palët shpesh e gjejnë veten në gjykata sit ë humbur, përmes grumbijve të njerëzve, avokatëve, palëve që duan informacione dhe ndihmë për plotësimin e formularëve, depozitim të kërkesave si dhe kryerjen e seancave të ndryshme gjyqësore.

Palëve shpesh u refuzohen shkresat apo kërkesat e tyre si të papërshtatshme apo të paplota, por nuk u jepet asnjë ndihmë për t'i korrigjuar ato, asnjë shpjegim i problemit si mund ta rregullojnë atë, ose ndonjë pikë referimi . Palët e vetë-përfaqësuar shpesh janë të hutuara në lidhje me statusin e rastit të tyre, cili duhet të

jetë hapi i ardhshëm, etj. Rastet mund të pushohen, palët e vetë-përfaqësuar dështojnë të ndërmarrin hapat e nevojshme për të dhe jo rralle gjykatat e konsiderojnë çështjen të braktisur duke marrë vendime pushimi.

- Mungesa e kuptimit të Vendimeve dhe Urdhrave të gjykatës dhe si t'i zbatojnë ato. Palët shpesh nuk i kuptojnë kushtet e urdhrave të gjykatës dhe vendimeve Pa një avokat, ata nuk janë në gjëndje t'i interpretojnë termet apo implikimet e tyre. Për më tepër, palëve shpesh u mungon një kuptim i mekanizmave ligjore për zbatimin e vendimeve të marra nga gjykatësi.

### III. Lloji i ndihmës për Vet-përfaqësim

Problem kryesor është njohja e palës me procedurat e gjykatës. Një mënyrë për ta realizuar këtë është nëpërmjet Pamfleteve, fletëpalosjeve, apo paketave informative përmbledhëse ku të ofrohen të gatshme hapat kryesorë të një procesi gjyqësor si:





- Depozitimi i Kërkesë/ ose Kërkesë Padisë
- Pagesa e taksës gjyqësore pranë sekretarisë së gjykatës
- Marrja dëgjimi për orën dhe datën e gjykimit nëpërmjet faqes zyrtare të gjykatës, ose nëpërmjet interesimit direkt në sekretarinë e gjykatës
- Përgatitja e të gjithë akteve proovuese në seancën përgatitore, që shoqërojnë Kërkesë Padinë;
- Ndjekja e seancave të mëtejshme gjyqësore në datat dhe orarin e përcaktuar nga gjykata;
- Pas përfundimit të procesit gjyqësor, tërheqja e vendimit përfundimtar të gjykatës;
- Nëse kërkesa është rrëzuar, apeli i këtij vendimi mund të bëhet pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit

#### IV. Cfarë ofron TLAS për të aftësuar klientët e ligjshëm të vetpërfaqësohen

Sic e përmendëm dhe më sipër, shërbimi clinics ofrohet nga avokatët e Shërbimit Ligjor Falas Tira-

në, TLAS në ato raste kur klientët kanë nivelin intelektual për të kuptuar njohuritë ligjore bazë për të ndjekur dhe përfaqësuar vetë çështjet e tyre përpara organeve administrative ose gjyqësore.

Si pjesë e këtij shërbimi, avokatët e TLAS hartojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm administrativ ose gjyqësor që ata ta paraqesin sipas nevojave të llojit të rastit që kanë. Ndër rastet që paraqiten në zyrë përmendim çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës, çështje familjare, administrative si dhe konflikte të tjera civile që lindin nga zgjidhja e marëdhënieve





të punës dhe mosmarrëveshje të ndryshme.

Vlen të theksohet se pothuajse çdo vit paraqiten shumë klientë të cilët kërkojnë të drejtën e tyre në lidhje me pronën dhe kryesisht këto konflikte shkaktohen nga vendimet e padrejta të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si dhe të Agjensisë së Kthimit të Pronave. Duke qenë se klientët nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre gjatë procedurave administrative pranë Komisioneve dhe Agjensisë i drejtohen gjykatave me kërkesë padi për të kundërshtuar këto vendime. Për këtë kategori përgatiten kërkesë

padi të për t'iu drejtuar gjykatës si dhe çdo dokument të nevojshëm ligjor i cili është i domosdoshëm gjatë procedurës gjyqësore.

Gjithashtu me shërbim clinics janë trajtuar mjaft raste administrative siç janë rastet kur qytetarëve të ndryshëm u refuzohet dhënia e dokumentave pranë zyrave shtetërore pa pasur një kërkesë me shkrim ose kur këto dokumenta duhet të paraqiten në gjykatë dhe i është kërkuar domosdoshmërisht një kërkesë me shkrim nga një avokat i licensuar.

Mund të themi se raste të tilla në qendrën tonë janë të shumta për çështje nga më të ndryshmet duke filluar që nga përgatitja e kërkesave për tërheqje certifikatash për proçese gjyqësore, përgatitje kërkesash për tërheqje certifikatash lindjeje pranë materineteteve, përgatitje kërkesash për kthim përgjigje me shkrim pranë institucioneve të ndryshme shtetërore të cilat janë të nevojshme për hapjen e një proçesi gjyqësor.

Gjatë viteve 2011-2013 është



vënë re një numër i madh kërkesash të këtij lloji që i janë drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore për të kërkuar dokumenta dhe shkresa në lidhje me një nga grupet e synuara të zyrës tonë siç janë pensionistët.

Një problematikë tjetër e hasur shpesh në shërbimin clinics janë konfliktet civile. Ndër këto raste konfliktet më të mëdha kanë të bëjnë me qytetarët të cilët kërkojnë korrigjimin e të dhënave të tyre personale të cilat figurojnë të pasakta ose të gabuara dhe që kërkojnë ti korrigjojnë gjyqësisht.

Nuk mungojnë gjithashtu edhe kërkesat për vërtetimin gjyqësor të fakteve të ndryshme siç mund të jenë gabime në dokumenta shtetërore, vërtetim i viteve të punës, vërtetim i kufijëve të pronës, vërtetim i lindjes së një fëmije, për mospërmblidhjen e detyrimeve kontraktuale ku palët kanë lidhur kontrata dhe nuk i janë përmbajtur kushteve të tyre. Gjatë dy viteve të fundit në këtë kategori vihet re një numër i madh çështjesh



që kanë të bëjnë me mosrespektimin e kushteve që rrjedhin nga kontratat e huapërdorjes ose të deklaratave noteriale që përmbajnë detyrime në të holla.

Edhe çështjet familjare zënë peshë në shërbimin clinics. Këto lloj çështjesh kanë pësuar një rritje të ndjeshme sidomos këto pesë vitet e fundit ku edhe konfliktet familjare janë bërë më të shpeshta.

Ajo çka mund të themi është se numrin më të madh të çështjeve e zënë çështjet që kanë të bëjnë me zgjidhjen e martesës (divorcet) të cilat vit pas viti janë dyfishuar, këto raste janë të shumta në komunitetin rom.

Çështje të tjera familjare që zënë një peshë të madhe janë kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijët e lindur jashtë martese, çështjet e kujdestarisë së të miturve dhe të përgjegjësisë prindërore, njohja e atësisë për fëmijët e lindur jashtë martese etj. Në mënyrë të përmblledhur problematikat e trajtuara nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë përsa i përket shërbimit clinics për periudhën Janar- Qershor 2013 jepen në tabelën e mëposhtme.

| Lloji i rastit           | Vetpërfaqsim ne Gjykatë | Vetpërfaqësime ne Administratë | Femra | Meshkuj | Total |
|--------------------------|-------------------------|--------------------------------|-------|---------|-------|
| Raste Pronesie           | 13                      | 15                             | 8     | 20      | 28    |
| Raste Kujdestarie        | 5                       | 3                              | 5     | 3       | 8     |
| Raste Konflikte Pune     | 3                       | 5                              | 1     | 7       | 8     |
| Raste pensioni           | 11                      | 4                              | 9     | 6       | 15    |
| Urdhër ekzekutimi        | 0                       | 10                             | 7     | 3       | 10    |
| Raste Zgjidhje Martese   | 4                       | 2                              | 5     | 1       | 6     |
| Raste Celje Trashësimie  | 8                       | 0                              | 3     | 5       | 8     |
| Raste Familjare          | 0                       | 6                              | 4     | 2       | 6     |
| Raste Regjistrimi Lindje | 0                       | 1                              | 1     | 0       | 1     |
| Te tjera                 | 17                      | 5                              | 10    | 12      | 22    |
| Total                    | 61                      | 51                             | 53    | 59      | 112   |

**Adrian Shega**  
**Avokat i TLAS**

## E DREJTA E MOHUAR E ANTARËVE TË SHOQA- TËS KOMBËTARE PËR MBROJTJEN E PUNËS DHE DEMOKRACISË NË SHQIPËRI (SHKMPD)

Midis Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS) dhe Shoqatës Kombëtare për Mbrojtjen e Punës dhe Demokracisë në Shqipëri (SHKMPD) ekziston një partnership i hershëm i cili është materializuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur në vitin 2002, objekti i së cilës është edhe ofrimi i shërbimit të plotë ligjor për klientët e përbashkët.

### **SHKMPD ka si mision ndihmën për:**

- shpërblimin e punës së papaguar të kryer në kushtet e vuajtjes së dënimit;
- njohjen e kësaj pune për efekt vjetërsie në punë për anëtarët e shoqatës;
- rehabilitimin-integrimin social në jetën politike e social ekonomike për të dënuarit jopolitikë (ordin-

erë) në Shqipëri.

Zyra për Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS), gjatë kësaj periudhe bashkëpunimi ka ndihmuar në përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim njohjen e periudhës së vuajtjes së dënimit si periudhë sigurimi për efekt pensioni, ka formuluar opinionin ligjor përkatës për vazhdimin e mëtejshëm të iniciativave advokuese dhe hapat lobuese të SHKMPD.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë ka asistuar në studimin e legjislationit në fuqi për pensionet dhe aspekte diskriminuese të tij për grupin e ish të dënuarve jo politik Rom dhe jo Rom.

Kjo ndihmë ka shkuar edhe më tej duke përfshirë edhe trajnimin e drejtuesve të SHKMPD, ngritjen e kapaciteteve të Shoqatës, përpilimin e listave të anëtarëve, përgatitjen e materialeve nga ekspertët e TLAS (në lidhje me boshllëkun ligjor për njohjen e viteve të punës gjatë periudhës së dënimit), në mënyrë që kjo organizatë të funksionojë në bazë të të

drejtave dhe detyrave që para-shikon ligji për OJF-të.

Në saj të bashkëpunimit me TLAS, shkresave drejtuar krerëve të institucioneve përkatëse shtetërore si: Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punës, Cëshjteve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Kryeministrit, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, rezultati i parë për kërkesat e Shoqatës arrihet me ngritjen e një grupi pune me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Nr. 119, datë 15/05/2002.

Urdhri parashikonte:

Ngritjen e grupit të punës për studimin dhe përgatitjen e projektakteve të nevojshme, ligjore apo nënligjore për njohjen e punës gjatë periudhës së burgimit, is vjetërsi pune, për efekt pensioni, për ish të dënuarit jopolitikë.

Grupi i punës të kryesohej nga zv Ministri i Punës dhe i Cëshjteve Sociale dhe të ketë anëtarë specialistë të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Financave.

Grupi i punës detyrohet të për-

katisë projektin përkatës Brenda muajit Korrik 2002.

Grupi i punës mund të kërkojë bashkëpunim me të tretët, për të përmbushur detyrat e ngarkuara.

Ky grup, i përbërë nga specialistët e Ministrive përkatëse dhe përfaqësuesit e Shoqatës, është mbledhur disa herë nga data e krijimit të tij deri në 30 Qershor 2004. Kryetari i grupit të punës, z. Ahmet Ceni me shkresën Nr. 275, dt. 03/06/2003, pasi përgatiti formularët e regjistrimit dhe urdhëroi Shoqatën të regjistrojë anëtarët e shoqatës që nuk marrin pension ose që marrin pension të pjesshëm. Në bazë të listave që shoqata do të paraqiste do të përpiloheshin edhe faturat buxhetore.

Si rezultat i këtyre mbledhjeve të dhenave u arrit:

- U regjistruan 3858 ish të dënuar jopolitikë të cilët nuk marrin pension ose që marrin pension të pjesshëm.
- Janë regjistruar 24312 vjet punë në burg.
- U llogarit edhe shuma e faturës buxhetore, pra kontributi që duhet

të derdhet në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Grupi i Punës i paraqet zv. Kryeministrit Namik Dokle propozimin dhe faturën buxhetore me shkresën Nr. 1184, datë 30/06/2004. Megjithatë grupi ende nuk e kishte përmbyshur qëllimin për të cilin ai u krijua, dhe për këtë arsye Kryesia e Shoqatës me kërkesë të saj u thirr në një takim nga ish zv. Kryeministri Namik Dokle me shkresën NR. 47/8, dt. 23.01.2005.

Në këtë mbledhje në të cilën kishte pjesëmarrës nga ministrinë përkatëse dhe nga Shoqata (Halil Kurti) nuk u pranua mënyra e regjistrimit të anëtarëve të shoqatës nga ish zv. Ministri i Financave Gjergj Teneqexhiu pasi listat duhet të legalizoheshin nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë dhe më pas të përcaktohet fatura buxhetore. Pas zgjedhjeve parlamentare të Korikut 2005aktiviteti i grupit të punës u pezullua.

Pas ndërprerjes së veprimtarisë së grupit të punës, shoqata i është drejtuar disa institucioneve

shtetërore me shkresa në të cilat kërkohet rifillimi i veprimtarisë së grupit të punës (shkresë drejtuar Kryeministrit, datë 09/01/2006).

Në përgjigje të këtyre kërkesave më datë 10/03/2006 u zhvillua një mbledhje në zyrën e kabinetit të Kryeministrit, z. Sali Berisha, në prani të sekretarit z. Androkli Xhaferi, Kryetarit z. Halil Kurtit, avokatit të Shërbimit Ligjor Falas, Z. Vangjel Kosta si dhe z. Elham Sharra. Si detyrë u la që kërkesat e shoqatës do të rikthehen për shqyrtim pranë Ministrisë së Punës dhe Cështjeve Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të sigurohet informacioni i saktë për listat e anëtarëve të shoqatës së pensionistëve dhe të legalizohen listat në Ministrinë e Drejtësisë.

Pas kësaj mbledhje shoqata i është drejtuar Ministrit të Financave, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të punës dhe Cështjeve Sociale në datë 27/03/2006, ku midis të tjerave kërkohet:

*“koha e kaluar në punë në burgje të njihet për pension në sigurimet*

shoqërore.

*Te rimblidhet grupi i punës ndërmintor i krijuar me urdhër nr. 119 datë 15/05/2002, të formulojë faturën buxhetore dhe të bëjë propozimin për pensionet e ish të dënuarve jopolitike (ordinerë).*

*Ministria e Drejtësisë (Zyra e Gjendjes Gjyqësore) të verifikojë dhe kontrollojë saktësimin e këtyre listave për shifrën 3858 anëtarë të shoqatës dhe identitetin e personave që përshkruhen në këto lista”.*

Qeveria e re mori angazhimin të zgjidhë shpejt këtë kërkesë duke përfshirë tek përfituesit një numër më të madh të të dënuarve jopolitikë. Nga shkresa Nr. Prot. 2437/1 datë 26/09/2006 e Ministrit të Drejtësisë përcaktohen si përfitues 2059 persona. Nga shkresa nr. Prot 759/4 dt. 07/12/2006 dërguar nga Ministria e Punës dhe Cështjeve Sociale shoqata është vënë në dijeni se cështja nuk po merr një zgjidhje për shkak se përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk mbledhen për të shqyrtuar kërkesën e të dënuarve

jopolitikë.

Për këtë arsye në adresë të Kryeministrit është dërguar një letër e përbashkët e drejtuesve të SHKMPD dhe TLAS. Në përgjigje të kësaj kërkesë Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr. Prot 426/4, datë 05/09/2007 na njofton se ka rikativizuar grupin ndërmintor të punës, nën drejtimin e zv. Ministrit të Punës Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Grupi do të ketë në përbërje të tij përfaqësues të Ministrisë së Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Nga ky grup është përgatitur projektvendimi “Për njohjen periodike sigurimi për efekt pensioni të kohës së punuar në burg, para datës 31/12/1998 për ish të dënuarit jopolitikë”, si dhe një relacion përkatës. Efekti financiar i këtij trajtimi është llogaritur mbi të dhënat



që disponon SHKMPD, pasi nuk ka të dhëna të tjera zyrtare nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Ky projekt vendim bashkë me relacionin përkatës i është dërguar me shkresë të Ministrisë së Punës, Cëshjteve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nr. 528/7, datë 11/07/2007, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Kabinetit të Kryeministrit dhe Shoqatës.

Në përmbledhje të këtij ekspozimi shihet se, nga ana e Shoqatës dhe TLAS është bërë një punë voluminoze e cila ende nuk është finalizuar. Nga ky ekspozim është e qartë se, e vetmja rrugë ligjore për të realizuar të drejtat e anëtarëve të shoqatës është ruga e ndjekur, nëpërmjet zbatimit të nenit 58 të ligjit “ për sigurimet shoqërore” dhe nëpërmjet derdhjes së kontributit nga ana e Qeverisë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Meqë kjo rrugë është e kushtëzuar me vullnetin vendimarrës të Këshillit të Ministrave, hapat e mëtejshëm duhet të synojnë “vënien

në presion” të KM për të nxjerrë aktin përkatës ( miratimin e projekt – Vendimit) me synimin final realizimin e të drejtave të mohuara ish-të dënuarve joPolitikë.

Në të gjitha kërkesat që TLAS ka drejtuar apo ndjekur është referuar kësaj baze Ligjore:

### **- Konventa Europiane e të**

**Drejtave të Njrit,** neni 14, parashikon se *Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*

### **- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,**

**Neni 52:** “1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i pa aftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.  
2. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të

tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj”.

**Neni 59:** “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private :

...

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët..

Përmbushja e objektivave social nuk mund të kërkohet drejtëpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave”.

**- Ligji nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R. e Shqipërisë”.**

**Neni 58**

Periudha e sigurimit.

Periudha e siguruar

“KM mund të deklarojë edhe periudha të tjera si periudha të sigurimit duke u derdhur kontributi në fondin e sigurimit shoqëror nga buxheti i shtetit”.

**Neni 91.**

Periudhat e quajtura si periudha sigurimi.

“Të gjitha periudhat e punësimit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të njohura si vjetërsi pune, të vlefshme për sistemin e sigurimit shoqëror të kaluar, do të quhen si periudha sigurimi edhe për këtë ligj.

Periudhat në të cilat nuk është punuar, por të njohura si vjetërsi pune për sigurimet shoqërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të njihen si periudha të sigurimit edhe për këtë ligj.

Koha pas hyrjes në fuqi të këtij ligji njihet si periudhë e sigurimit shoqëror vetëm kur është derdhur kontribut sipas këtij ligji”.

Ligji i Sigurimeve Shoqërore i ndryshuar të paktën 15 herë që nga miratimi i tij i parë. Sipas ligjit, një mashkull ka të drejtën e : (i) një pensioni të plotë pleqërie në moshën 65 vjeç, pasi ka 35 vjet sigurim, (ii) një pensioni të reduktuar pleqërie në moshën 65 vjeç, pasi ka plotësuar 32 vjet sigurim; (iii) pensioni të pjesshëm pleqërie në moshën 65 vjeç, pasi ka plotësuar 15 deri 35 vjet sigurim.

**- Ligji për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore (Ligji nr. 9355 i datës 10 mars 2005)**

Neni 5 i ligjit parashikon që familjet në nevojë, që janë familje me asnjë burim të ardhurash apo me të ardhura të pamjaftueshme, kanë të drejtë për ndihmë ekonomike (Ndihma Ekonomike), e cila mund të jepet në mënyrë të plotë ose të pjesërisht. Ajo përbëhet nga një pagesë mujore në para ose në natyrë. Kryefamiljari bën një kërkesë për ndihmë ekonomike tek administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore, ku banojnë familja. Vendimi që refuzon dhënien e ndihmës ekonomike mund të apelohej në gjykatë.

**- Pika 10 (c) e vendimit të Qeverisë nr. 787 i datës 14 dhjetor 2005,** parashikon që familjet, një anëtar i së cilës jeton jashtë vendit për çfarëdo arsye, me përjashtim të studimeve apo trajtimit mjekësor, do të përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike.

**- Ligji për të Drejtat dhe Trajtimin e të Denuarve me Burgim (Ligji nr. 8328 i datës 16 prill 1998, i ndry-**

**shuar me ligjin nr. 9888 i datës 10 mars 2008).**

Ligji për të Drejtat dhe Trajtimin e të Denuarve me Burgim, rregullon të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e autoriteteve kompetente.

Neni 34 i njeh të drejtën e të burgosurve për të punuar (të gjithë të dënuarve u njihet e drejta për të punuar), e cila mund të kryhet brenda ose jashtë institucionit të burgut. Puna shpërblehet në përputhje me kriteret e përcaktuara me vendim të veçantë të Qeverisë.

Neni 35 parashikon që puna e kryer në burg merret parasysh në llogaritjen e pensionit të pleqërisë. Vendimi i qeverisë nr. 396 i datës 27 korrik 2000 përcakton kriteret për llogaritjen e përfitimit të pensionit të pleqërisë.

Në Janar të vitit 2013 në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, njoftohet shqyrtimi i një aplikimi të një anëtari të SHK-MPD, aplikim i regjistruar pranë kësaj gjykate si çështja Canaj

kundër Shqipërisë.

Z. Canaj si anëtar i shoqatës përfaqësone kauzën në të cilën prej vitesh ishte përfshire edhe TLAS për ta zgjidhur. Në këto kushte, bazuar në të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare, SHKMPD përfaqësuar nga TLAS, bëri kërkesë për të marrë pjesë si palë e tretë dhe u pranua si e tillë në çështjen në fjalë, bazuar në nenin 36 në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, për të dhënë komente me shkrim dhe sqarime lidhur me situatën ligjore dhe hapat ligjore të ndërmara për të zgjidhur çështjen në shtetin Shqiptar.

Ndërhyrja e SHKMPD dhe TLAS në çështjen Canaj kundër Shqipërisë ishte një përpjekje jo vetëm për të orientuar gjykatën lidhur me përpjekjet e bëra për zgjidhjen e këtij problemi, por njëkohësisht për të bërë të njohur që në kushtet e z. Canaj ndodheshin dhe një numër i madh ish të dënuarish jo-politikë.

Në komentet e saj për gjykatën TLAS si përfaqësues i SHKMPD

parashtroi në mënyrë të përmblodhur:

**1.** Në rastin në shqyrtim vetë Qeveria pranon se “e drejta e pensionit që pretendon aplikanti kushtëzohet nga miratimi i një akti normativ nga Qeveria për pagimin prej saj ( nga buxheti i shtetit) të kontributeve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”.

**2.** Nisur nga ky kushtëzim normativ i së drejtës së pretenduar prej aplikantit është e qartë se, asnjë mjet i brendshëm nuk mund të jetë efektiv për të detyruar Qeverinë të nxjerrë aktin e sipërpërmendur normativ dhe për të paguar nga buxheti i shtetit fondin përkatës.

**3.** Pretendimi se një mjet i tillë mund të jetë gjykata e cila sipas Kodit të Procedurës Civile mund të vërtetojë faktin se aplikanti ka punuar apo se nëpërmjet Kodit të Procedurës Civile mund të zgjidhë kërkesën e aplikantit edhe në mungesë të ligjit është e pabazuar.

**4.** Aplikanti nuk mund t'i drejtohet gjykatës për të provuar se ai ka punuar gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit me burgim (sipas nenit

388 të Kodit të Procedurës Civile) pasi një të drejtë të tillë e kanë vetëm personat të cilët provojnë këtë fakt nëse prej këtij fakti kanë një interes të ligjshëm, pra nëpërmjet këtij fakti përfitojnë të drejtën e pensionit. Në rastin e punës së kryer gjatë vuajtjes së dënimit me burgim, edhe vetë Qeveria e pranon se legjislacioni shqiptar i para vitit 1998, nuk e njeh këtë periudhë pune në kohën e vuajtjes së dënimit me burgim për efekt të pensionit.

**5.** Gjykatat shqiptare nuk mund të aplikojnë drejtëpërdrejt " të drejtën e pretenduar të pensionit" sipas nenit 2 të Kodit të Procedurës Civile, pasi sipas nenit 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë gjyqtarët mund të zgjidhin çështjet vetëm duke u bazuar në Kushtetutën e R. së Shqipërisë dhe në ligjet.

**6.** Sipas neneve 52 dhe 59 të Kushtetutës së R. së Shqipërisë, si e drejta e pensionit ashtu edhe mbrojtja sociale e shtresave marginale mund të kërkohej të mbrohet nëpërmjet gjykatës vetëm nëse është parashikuar drejtëpërdrejt në ligj.

**7.** Në rastin konkret, e drejta e pretenduar prej aplikantit, e drejta e pensionit përkundrejt kontributeve publike të punës gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit me burgim para vitit 1998, nuk është një e drejtë e parashikuar drejtëpërdrejt në legjislacionin shqiptar, fakt ky i pranuar edhe nga Qeveria.

**8.** Edhe Gjykata Kushtetuese e R. së Shqipërisë, megjithë kompetencat e rëndësishme të parashikuara nga Kushtetuta e R. së Shqipërisë nuk ka asnjë kompetencë në detyrimin e Shtetit Shqiptar në miratimin e akteve normative që krijojnë mundësinë e realizimit të së drejtës së pensionit pasi në nenin 131 të Kushtetutës së R. së Shqipërisë janë përcaktuar në mënyrë indikative kompetencat e saj të cilat kanë natyrë shfuqizuese të akteve dhe jo krijuese të akteve të reja.

**9.** Kategoria e personave të cilëve u përket aplikanti përfaqëson një shtresë të diskriminuar të popullsisë së Shqipërisë.

**10.** Vetë Qeveria e pranon faktin se legjislacioni gjatë rregjimit komunist ka cënuar rëndë liritë dhe të drejtat e tyre themelore.

**11.** Sistemi i së drejtës gjatë rregjimit komunist përdorej si mjet i rregjimit për të shtypur kundërshtarët e rregjimit.

**12.** Jo rrallë, nëse këta kundërshtarë nuk dënoheshin drejtëpërdrejt për krime politike u montoheshin procese ligjore për krime jopolitike. Mungesa e një procesi të rregullt ligjor në atë kohë është një fakt i pranuar pa asnjë kundërshtim edhe nga Qeveria.

**13.** Në shumë raste, të dënuarit për krime politike dhe të dënuarit për krime jo politike vuanin dënimin në të njëjtat institucine të vuajtjes së dënimit dhe kryenin të njëjtën punë, zakonisht në sektorët më të vështirë të punës.

**14.** Por, ndërsa, natyrisht me të drejtë, shteti shqiptar, me ligjin nr. 7514 datë 30.09.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë" i njohu kësaj kategorie të drejtën e pensionit për vitet e punës në burg që në vitin 1991, për kategorinë e të dënuarve për krime jopolitike një e drejtë e tillë analoge ende nuk është njohur edhe sot por deklarohet se "është në proces studimi

të të dhënave dhe pasojave në buxhetin e shtetit".

**15.** Pasojat e këtij qëndrimi janë shumë të rënda përse i përket kushteve të jetesës së kësaj kategorie personash.

**16.** Aplikanti është njëri prej tyre. Koha e gjatë e vuajtjes së dënimit me burg i ka hequr atij mundësinë që të plotësojë vitet e punës që kërkohen nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë.

**17.** Për rrjedhojë, megjithëse aplikanti, nëpërmjet punës së kryer në vitet e vuajtjes së dënimit me burgim ka kontribuar drejtëpërdrejt në dobinë ekonomike publike nëpërmjet punës së kryer dhe të papaguar, tanimë kjo punë nuk i konsiderohet si kontribut për të përfituar të drejtën e pensionit të pleqërisë.

**18.** Mosnjohja e së drejtës së pensionit të pleqërisë ka sjellë si pasojë kushte ekonomike mjaft të rënda në jetën e aplikantit.

**19.** Vitet e gjata të vuajtjes së dënimit me burgim, pasuar me vështirësi shumë të mëdha ekonomike në periudhën e pas vuajtjes së dënimit me burg, kanë



sjellë pasoja të rënda në shëndetin e aplikantit. Për rrjedhojë, integrimi i tij në kushtet e një jetese normale kërkon shpenzime më të mëdha për të ndërtuar një jetesë në kushte normale. Kjo gjëndje e vështirë ekonomike ka ndikuar edhe në jetën familjare duke nxitur një jetesë të vecuar familjare megjithë nevojën ekstreme që ka aplikanti për ndihmën e pjestarëve të tjerë të familjes.

**20.** Lidhur me pretendimin e Qeverisë se “ka udhëzuar strukturat shtetërore për trajtim të posacëm të kësaj shtrese” përfaqëson vetëm një deklaram pa asnjë mbështetje provuese.

**21.** Përkrahja e shtresave të vecanta të popullsisë mund të bëhet vetëm nëpërmjet akteve normative që u ofrojnë këtyre shtresave avantazhe specifike në raport me pjesën tjetër të popullsisë (diskriminimi pozitiv).

**22.** Për grupin e personave që përfaqëson aplikanti asnjë akt normativ nuk rezulton të jetë miratuar.

**23.** Përsa i përket “ndihmës ekonomike” që përfiton aplikanti duhet mbajtur në konsideratë fak-

ti që kjo ndihmë nuk siguron qëndrueshmëri.

**24.** Nëse pensioni është një e drejtë që ofron siguri për të gjithë periudhën pas miratimit, “ndihma ekonomike” përfaqëson një kontribut të paqëndrueshëm pasi ajo rishikohet në vazhdimësi (për cdo vit) në varësi të mundësive financiare të pushtetit vendor i cili ka detyrimin ligjor që t'a miratojë atë.

**25.** Për më tepër ajo aktualisht është një masë tepër të vogël dhe plotësisht e pamjaftueshme për t'i ofruar aplikantit një jetesë normale në kushtet e pasojave të tij ekonomike, sociale dhe shëndetsore për shkak të vuajtjeve të mëdha nga kushtet shumë të rënda të jetës në vitet e vuajtjes së dënimit me burgim apo edhe më pas në kushtet e mungesës së plotë për integrim në jetën sociale.

**26.** Vetë fakti i ndërprerjes së kësaj ndihme dhe i rilidhjes së saj (pas aplikimit në Gjykatën Europiane) tregojnë më së miri paqëndrueshmërinë dhe mungesën e sigurisë së saj si burim i kushteve edhe më minimale për jetesë.

**27.** E drejta e tyre për të përfituar pension pleqërië sipas ligjit shq-

iptar të sigurimeve duke njohur si "vite pune" edhe vitet e vuajtjes së dënimit me burgim, përbën një të drejtë pasurore që mbrohet nga neni 1 i protokollit nr. 1.

**28.** Është vërtetë që Gjykata ka pranuar në jurisprudencën e saj se është drejtë shteteve që të përcaktojnë masat dhe kriteret e përfitimëve, edhe në rastet kur ato konsiderohen si kompensim të shkeljeve të mëparshme të regjimeve komuniste mbi individët.

**29.** Por, nga ana tjetër kjo e drejtë diskreionale shteteve nuk mund të konsiderohet absolute.

**30.** Duhet të mbahet parasysh natyra e këtyre të drejtave si të drejta më natyrë të përzier dhe jo thjesht si "kompensim material".

**31.** Shtetet kanë të drejtë të ndërtojnë rregulla që balancojnë të drejtën e personave të cilëve u deklarohet të drejtën e kompensimit më masën dhe kohën e këtij kompensimi duke mos vështirësuar pjesën tjetër të popullsisë.

**32.** Në parashikimin e rregullave të hollësishme të së drejtës së kompensimit, në rastin konkret të së drejtës për të përfituar pension pleqërie duke paguar Qeveria

kontributet e sigurimeve, duhen mbajtur parasysh parime të tilla si "pritshmëri e ligjshme" apo "drejtësi sociale".

**33.** Qeveria "ka premtuar" nëpërmjet akteve konkrete të saj (të përmendura më sipër), se do të ndërmarrë veprime konkrete për të nxjerrë aktet e nevojshme normative dhe për të paguar kontributin përkatës të sigurimeve që nga viti 2002, por deri më sot ende nuk ka asnjë akt konkret të detyrueshëm për t'a bërë të kërkueshme këtë të drejtë për ish-të dënuarit jopolitikë.

**34.** Në rastin e grupit të personave ish-të dënuar jopolitikë duhet mbajtur parasysh koha si një element i rëndësishëm i cili mund t'a kthejë këtë të drejtë, të drejtën e pensionit, në një deklaram të pamundshëm për t'u realizuar për shkak të vdekjes së personit përfitues.

**35.** Duhet mbajtur në konsideratë se, pjesa më e madhe e anëtarëve të Shoqatës që pretendojnë të përfitojnë këtë të drejtë kanë një moshë mesatare mbi 65 vjeç.

**36.** Për rrjedhojë, vonesa e miratimit

mit të akteve të domosdoshme normative që do të siguronin për këtë kategori personash gëzimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë ka krijuar një gjendje pasigurie lidhur më gëzimin e kësaj të drejte.

**37.** Qeveria shqiptare ka qënë drejtëpërdrejt subjekt i sugjerimeve të Gjykatës lidhur me masat që duhet të marrë për të mos lejuar që “pritshmëritë e ligjshmë” të kthehen në deklarimë të “papërmbushshme”.

**38.** Konkretisht, në vendimet Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë (ankimi nr.38222/02) apo çështja Afërdita Hamzaraj kundër Shqipërisë (ankimi nr. 45265/04) etj, është theksuar shprehimisht se “Dukë pasur parasysh që nuk ekzistojnë rregulla të qarta ligjore në të drejtën e brëndshme lidhur më llogaritjen e kompensimit ose ndonjë procedurë tjetër e ngjashme për të ekzekutuar (në rastet në fjalë vendimet e komisionit lidhur me kompensimet e pronave), Gjykata nuk e vlerëson këtë argument, si shumë bindës, duke mbajtur në konsideratë faktin se ishte pikërisht mosveprimi i autoriteteve që shkaktoi

“ndërhyrje” lidhur me çështjen në fjalë. Në çdo rast, ankuesit nuk duhet të pengoheshin të përfitonin nga zgjidhja me sukses e mosmarrëveshjes, në favor të tyre, mbi bazën e vështirësive të pretenduara, që po kalonte shteti”.

**Aktualisht kjo çështje është në shqyrtim nga Gjykata Europiane dhe jemi në pritje të një vendimi i cili do të konstatojë shkeljen e bërë nga ana e shtetit Shqiptar e njëkohësisht do i hapë rrugë zgjidhjes së kësaj çështjeje e vendosjen në vend të një të drejte të mohuar.**

